


Shtojca 2: Aplikacion për dhënien e Lejes Mjedisore

APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	„ZHURI” Sh.p.k.
	Vendi	Kreks- Zhur, Komuna e Prizrenit
	Adresa	Tranziti pn. Prizren
	Nr. i tel./fax	+383 044 159 298
	E-mail	zhuri.shpk@gmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	Nr. 810974114; dt. 26.01.2016
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	z.Bekri Susuri
	Nr. i tel./fax	+383 044 159 298
	E-mail	zhuri.shpk@gmail.com
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	z.Qendrim Susuri
	Nr. i tel./fax	+383 43 771 190
	E-mail	zhuri.shpk@gmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	„Zhuri” SH.P.K. Shfrytëzim i Gurit Gëlqerorë
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Kreks-Kreks, zona kadastrale Zhur komuna e Prizrenit

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	<p>Pershkrimi i lokacionit</p> <p>Vendburimi gëlqeror në lokacionin e quajtur “Kreks—Kreks”, shtrihet ne anën Veri - Lindore te fshatit Zhur komuna e Prizrenit, fshati shtrihet ne veri-Perëndim te Prizrenit ne distancë jo te largët nga Prizreni ne anën e majtë përgjatë rrugës Prizren - Kukës në një distance afërsisht 8 km nga Prizreni dhe vendburimi gjendet në anën e majtë të rrugës Prizren – Zhur – Kukës, dhe ne anën e majtë të rrugës Zhur - Dragash nga aspekti administrativ i takon Komunës së Prizrenit.</p> <p>Komuna e Prizrenit me sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % territorit të Kosovës) gjendet ne jugperëndim të Kosovës. Prizreni Kufizohet me Komunat e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Shtërpcës dhe Dragashit si dhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Për këtë arsye rrafshi i Prizrenit gjendet në lartësi mbidetare rreth 400 metra dhe disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë 2000 m të lartësisë mbidetare. Lokacioni i planifikuar për eksploatimin e gurit gëlqeror gjendet ne anën e majtë të rrugës regjionale Prizren-Zhur- Kukës, gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 02829-0/1, fleta poseduese nr. P-71813026-02829-0, Zona Kadastrale Zhur, komuna e Prizrenit, ne vendin e quajtur Kreks - Kreks me kulturë Kullos klasa e shtat (7) me sipërfaqe prej S= 4 9141m² , Zona Kadastrale Zhur, komuna e Prizrenit. Pjesa e ngastrës është pronësi shoqërore e Ekonomisë të pyjeve të Kosovës që shihet nga Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, të cilën përfaqësuesi i kompanisë kompania „Zhuri” Sh.p.k. Prizren e ka marr ne shfrytëzim nga Agjencia pyjore e Kosovës. Lokacioni ku planifikohet të eksploatohet guri gëlqeror shihet ne pjesën e hartës topografike të më poshtme.</p> <p>Pershkrimi I lokacionit</p> <p>Vendburimi gëlqeror në lokacionin e quajtur “Kreks—Kreks”, shtrihet ne anën Veri - Lindore te fshatit Zhur komuna e Prizrenit, fshati shtrihet ne veri-Perëndim te Prizrenit ne distancë jo te largët nga Prizreni ne anën e majtë përgjatë rrugës Prizren - Kukës në një distance afërsisht 8 km nga Prizreni dhe vendburimi gjendet në anën e majtë të rrugës Prizren – Zhur – Kukës, dhe ne anën e majtë të rrugës Zhur - Dragash nga aspekti administrativ i takon Komunës së Prizrenit.</p> <p>Komuna e Prizrenit me sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % territorit të Kosovës) gjendet ne jugperëndim të Kosovës. Prizreni Kufizohet me Komunat e Gjakovës, Rahovecit,</p>
------	--	--

Suharekës, Shtërpcës dhe Dragashit si dhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Për këtë arsye rrafshi i Prizrenit gjendet në lartësi mbidetare rreth 400 metra dhe disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë 2000 m të lartësisë mbidetare. Lokacioni i planifikuar për eksploatimin e gurit gëlqeror gjendet në anën e majtë të rrugës regjionale Prizren-Zhur- Kukës, gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 02829-0/1, fleta poseduese nr. P-71813026-02829-0, Zona Kadastrale Zhur, komuna e Prizrenit, në vendin e quajtur Kreks - Kreks me kulturë Kullos klasa e shtat(7) me sipërfaqe prej $S= 4\,9141\text{m}^2$, Zona Kadastrale Zhur, komuna e Prizrenit. Pjesa e ngastrës është pronësi shoqërore e Ekonomisë të pyjeve të Kosovës që shihet nga Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, të cilën përfaqësuesi i kompanisë kompania „Zhuri” Sh.p.k. Prizren e ka marrë në shfrytëzim nga Agjencia pyjore e Kosovës. Lokacioni ku planifikohet të eksploatohet guri gëlqeror shihet në pjesën e hartës topografike të më poshtme. *Pozita Gjeografike e parcelës*



2.2.	Numri kadastral i parcelës	Lokacioni i Lokacioni për eksploatimin e gurit gëlqeror gjendet në anën e majtë të rrugës regjionale Prizren-Zhur- Kukës, gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 02829-0/1, fleta poseduese nr. P-71813026-02829-0, zona kadastrale Zhur, komuna e Prizrenit, në vendin e quajtur Kreks-Kreks, kulturë kullos klasa e shtat(7) me sipërfaqe $S= 4\,9141\text{m}^2$.
------	----------------------------	---

2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	<p>Në afërsi të drejtëpërdrejt të Lokacioni ku bëhet eksploatohet guri gëlqeror më lart kemi prezentuar, hartën topografike, shtëpitë e banimit më të afërta të fshatit janë të larguara nga frontet punuese të gurores mbi 1500m, prandaj s'është e nevojshme që të bëhen matjet detale sizmike të efekteve të cilat do të lajmërohen gjatë minimumit.</p> <p>Në anën tjetër gurorja lidhet me rrugën Zhur-Dragash e cila pastaj lidhet me rrugën magjistrale Prizren – Vermic - Kukës. Nga këto të dhëna shihet se transporti rrugor i vendburimit është shumë i përshtatshëm.</p>
2.4.	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	<p>Bimësia dhe vegjetacioni - Flora</p> <p>Në bazë të shqyrtimeve vizuale të zonës ku kryhet aktiviteti i i Shfrytzimit të Gurit Gëlqerorë, kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulëta barishtore, manaferra, shkurre kurse ne hapësirën më të gjerë të ngastrës edhe shkozë, qarr, bung, etj. Gjithashtu kemi hasur në këtë zone edhe në bimët që u përshtaten kushteve të jetës së tyre në kto shtresa humusore.</p> <p>Bota shtazore – Fauna - Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike si dhe në bazë të të dhënave nga vendasit në këtë zonë përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, derri i egër, dhelpra, ujku, iriqi, etj. Prej brejtësve- minjtë, prej zvarranikëve: gjarpërinjtë, breshka e tokës, zhapini i gjelbër etj, nga insektet: mizat, mushkonjat etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, fëllënëzat e fushës, lejleku, shqiponja etj.</p>
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	<p>Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë terren të afërt me lokacionin ku bëhet shfrytzimi i gurit Gëlqerorë nuk kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje. Ndërsa në distancë më të largët ose nese flasim për komunën e Prizrenit si zona të veçanta të mbrojtura kemi: Malet e Sharrit.</p>

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore

3.1.1	Skema e procesit teknologjik	<p><i>Bashkëngjitur gjeni edhe tek Shtojca 1</i></p> <p style="text-align: center;">Skema e eksploatimit të shkëmbinjve gëlqeror</p> <div style="text-align: center;"> <p>Procesi i punës Ndarja nga masivi Ng arkimi</p> <div style="display: flex; align-items: center; justify-content: center;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-right: 10px;">Shpim minimi Ngarkuesi UL-200</div> <div style="margin-right: 10px;">→</div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-right: 10px;">ROC601</div> <div style="margin-right: 10px;">→</div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px;">amonit</div> </div> <p style="margin-top: 10px;">Transporti</p> <div style="display: flex; align-items: center; justify-content: center; margin-top: 10px;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-right: 10px;">auto kamioni 10³m</div> <div style="margin-right: 10px;">↓</div> </div> <p style="margin-top: 10px;">Makina për thërrmim</p> <div style="display: flex; align-items: center; justify-content: center; margin-top: 10px;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-right: 10px;">Seperacioni primar dhe sekondar Q=60m³/h</div> </div> </div>
3.1.2	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	<p>Procesi Teknologjik i Shfrytzimit te gurit gelqerore</p> <p><i>Vendshfrytzimi i gurit gëlqeror në Kreks-Kreks të kompanise Zhuri -shpk</i></p> <p style="text-align: center;">HAPJA DHE ZHVILLIMI I MIHJES SIPËRFAQSORE (KARRIERËS)</p> <p>Përcaktimi i parametrave teknologjik të karrierës. Një prej parametrave kryesor teknologjik, ku m'varet organizimi i procesit të punës në karrierë është lartësia e shkallës.</p> <p>Përcaktimi i lartësisë së shkallës Faktorët kryesor që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së shkallës janë: Konfiguracioni i terrenit Përbërja dhe lloji i vendburimit Vetitë fiziko mekanike të shkëmbit Sigurimi i kushteve për punë në karrierë Kapaciteti prodhues Mekanizmi i angazhuar në karrierë. Vendbanimet, lëvizja e gjallesave dhe popullatës e tje.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mënyra e shfrytëzimit -Shfrytëzimi i shkëmbive gëlqeror bëhet duke e ndarë mihjen sipërfaqësore në shtatë shkallë me lartësi h=10 m. <p>Kompania është në fazën e përgaditjes së dokumentacionit për licencë, dhe po sata marrë lejen e shfrytëzimit do të filloj me përgatitjen e minierës për shfrytëzim siç janë: Ndërtimin e rrugëve për tu afuar te shkallët e shfrytëzimit dhe përgatitjen për minim e tje. Shfrytëzimi do të filloj prej së larti me hapjen e shkallës parë në K.530m në jug -</p>

perëndim- të ngastrës duke vazhduar me shfrytëzim kah veri- lindja. Në hartat e shfrytëzimit e kemi paraqit, ku do të filloj shfrytëzimi në mihjen sipërfaqësore.

Pas një kohe të shfrytëzimit në këtë shkallë, do të hapet shkalla e dytë në jug-perëndim në k.520m, duke përparuar me shfrytëzim kah veri- lindja. Kështu do të vazhdoj shfrytëzimi me shkallë kah pjerrtësia deri në fazën përfundimtare të shfrytëzimit në k.470m

Gjatë shfrytëzimit në shkallë, duhet me pas kujdes që mos të kalohen kufijtë e minierës.

Në shtojcat grafike është paraqit ndërtimi i rrugës për shfrytëzim në mihjen sipërfaqësore.

Shfrytëzimi prej së larti do të jetë më i përshtatshëm për shkak se mund të mbahet rregull më të mirë në shfrytëzimin e minierës.

Shfrytëzimi në minierë, duhet të ketë rregull dhe ndërtim të mirë të shkallëve, që mihja sipërfaqësore të ketë siguri dhe pamje të mirë.

E tërë mënyra e shfrytëzimit është paraqit në shtojcat grafike.

Kompania nuk do të ketë vështirësi në ndërtimin e rrugëve të shfrytëzimit në pjesën perëndimore, pasi që tereni ka pjerrtësi të butë rrethe 9^0 .

Gjatë shfrytëzimit duhet të ketë kujdes në kufijtë e minierës, duke i lër 2m për thurje të minierës, si që është paraparë me rregulloren e mbrojtjes në mihjet sipërfaqësore.

Kështu vazhdon shfrytëzimi deri në fazën përfundimtare të mihjes sipërfaqësore duke pas kujdes në parametrat e mihjes sipërfaqësore si që janë: lartësia e shkalles $h=10m$, $b=5m$, $\alpha=60^0$ dhe $\beta=70^0$ e parametrat të tjerë që mihja sipërfaqësore të ketë formë të përshtatshëm dhe të sigurte në punë.

Shfrytëzimi në mihjen sipërfaqësore bëhet duke aplikuar shpimet e thella me diametër 76_{mm} ose 86_{mm} dhe minim masovik.

Me rregulloren e mbrojtjes duhet të mbesin min. 4m për thurjen e minierës. Duke u bazuar në rezerva të dobishme, në lartësinë e shkalles $h=10m$, pjerrtësinë e skarpates në përfundim të shfrytëzimit $\alpha =60^0$ në stabilitet të lart të shkëmbinjve gëlqeror mjaftojnë edhe 2m për thurjen e mihjes sipërfaqësore.

Ne këtë mënyrë do të jetë transporti më i letë i shkëmbinjve gëlqeror për në impiant. Gjatë shfrytëzimit kompania duhet të ketë kujdes në ndërtimin e rrugëve në vend të duhur që të jen të përshtatshme për transport

E ter mënyra e lëvizjes së shfrytëzimit është paraqit në shtojcat grafike.

Hapeja e rrugëve është e nevojshme për të hyrë dhe dalë nga shkalla në mihjen sipërfaqësore. Në këto rrugë do të lëvizin: ekskavatorët, kamionët për transport, makina e shpimit etj.

Rrugët e mihjes sipërfaqësore mundë të kenë pjerrtësi max. 20% që do të thotë në 100_m mund të ngritët ose zbresin 20_m

Me rregulloren e mbrojtjes, rrugët në mihje sipërfaqësore mund të kenë pjerrtësi max. 9^0 . Rrugët e minierës mund të kenë pjerrtësi të letë për transport të shkëmbinjve për në impiant.

Në për çarje (zgavra) të shkëmbinjve gëlqeror është i futur sterili i cili e zvogëlon kualitetin e shkëmbinjve gëlqeror. Ky varfërim llogaritet të jetë 7%

. Mihja sipërfaqësore duhet të ketë rënie të vogël për largimin e ujit. Kjo rënie mund të jetë 3-5‰ ose 3-5m në 1000m

Lartësia e mihjes sipërfaqësore është K.540m-470m ose
 $H=540m - 470m = 70m$

Investitori po sa ta marr lejen për shfrytëzim do të filloj me përgatitjen e mihjes sipërfaqësore për minim në shkallë të parë.

Pas shfrytëzimit në mihjen sipërfaqësore do të fillon rikultivimi.

Për shkaqe sigurie, në mihjen sipërfaqësore duhet të minohet me sistemin iniciues nonell.

- **Gjerësia e shkallës**

Duke u bazuar në shfrytëzimin e shkëmbinjve gëlqeror me fortësi të mesëm. Gjerësia e shkallës përcaktohet:

$$S=A+C_1+E+C_2\dots m$$

Gjerësia e shkëmbit të minuar është llogaritur të jen : $A=10m$.

Gjerësia e sheshit të sigurisë në skaj të rrugës transportuese duhet të jetë baza e poshtme e formacionit të minuar, përvetësohet në at mënyrë që ajo të merret minimale nga aspekti i humbjeve të shkëmbit të shfrytëzuar dhe të mundësoj lëvizjen pa pengesa të pajisjeve transportuese gjatë procesit të shfrytëzimit dhe si e tillë përvetësohet $E=3.5m$.


Gjerësia e sheshit të sigurisë në bazë të parametrave të përmendur përvetësohet $C_2=3m$.

Me rregulloren e mbrojtjes skaj i sheshit të shkallës të pjerrtësia e shkallës tjetër, duhet të ngritët me material minimum $1m$ për të penguar rënien e punëtorëve dhe mjeteve transportuese në thellësi,

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme, për punë normale në shkallë, gjerësia e sheshit të shkallës duhet të jen : $S_{min}=A+C_1+E+C_2=10+2+3.5+3=18.5m$


Në rastin kur ekskavatori ose buldozheri shtyn material prej shkallëve të larta pa transport $E=3,5m$

Gjerësia e shkallës është: $S_{min}=A+C_1+C_2=10+2+3=15m$



- **Këndi i pjerrtësisë së ballit punues**

Pas eksploatimit të shkallëve do të kemi një kënd të caktuar në raport me horizontin.



β – këndi punues i pjerrtësisë së shkallës; 70°

Në këndin e pjerrtësisë së shpatit ndikojnë edhe çarjet (shtresat) e shkëmbit gëlqeror. Si për shembull:

$$F_{tr} = Q (\sin \alpha - f \cdot \cos \alpha) = 0$$

F_{tr} – Forca e rrëshqitjes = 0 që do të thotë se masivi është në ekuilibër.

$Q (\sin \alpha - f \cdot \cos \alpha)$ nga kjo del:

$Q (\tan \alpha - f) = 0$ ose $\tan \alpha = f$ nëse $\tan \alpha$ është i barabartë me koeficientin e fërkimit në mes shtresave, trupi është në ekuilibër.

α - këndi i stabilitetit të pjerrtësisë 60°

Nga literatura propozohet, nëse shtresat kanë rënie mbi 30° duhet të merret edhe pjerrtësia e skarpatës e njëjtë me rënien e shtresave.

Në pjerrtësinë e shkëmbinjve të skarpatës ndikojnë edhe ujërat (reshjet atmosferike).

Ujrat bëjnë presion në qarje, dhe mund ti zgjerojnë deri në shembje.

$$C_2 = h \cdot (\tan \alpha - \tan \beta) \dots m \quad C_2 = 10_m (\tan 60^\circ - \tan 70^\circ) = 10 \cdot 0,21 = 2m$$

-Zona M është zonë jo stabile, ku nuk lejohet të vendosen makinat e as mjete tjera me peshë.

-Ndërsa C_1 nga literatura nuk lejohet të merret më i vogël se 2m.

Përvetësimi i këndeve bëhet nga tabela e librit për mihje sipërfaqësore të autorit Novica Spasiç të përvetësuar nga llogaritjet e varianteve të ndryshme për stabilitet të pjerrtësisë së shpatit për llojet të ndryshme të shkëmbinjve si që janë: Shkëmbit monolit, vullkanik, sedimentar e etj.

Qëndrueshmëria e shkëmbinjve gëlqeror klasifikohen në shkëmbi me fortësi të shkëmbinjve sedimentar.

▪ **Koeficienti i sigurisë.**

Duke marrë parasysh se në shkëmbit gëlqeror ka lidhshmëri (C) të lart që do me thënë se ka siguri të lart. Duhet të merr parasysh, se pjesët anësore aty ku shfrytëzohet shkëmbi gëlqeror në pjerrtësi të skarpatës mbesin në disa vende argjilat dhe rreshpe që janë me lidhshmëri të vogël.

Ne do të paraqesim koeficientin e sigurisë në këto skarpatat për argjila.

Për llogaritjen e koeficientit të sigurisë në pjesët anësore të skarpatave në argjilë në mihjen sipërfaqësore është sipas formulës: Koeficienti i sigurisë për lartësinë e

shkallës h=10m në mihjen sipërfaqësore është caktuar me formulën:

$$K_s = \frac{M_s}{M_o}$$

$$K_s = \frac{M_s}{M_o} = \frac{C * F * R + \sum N * tg \alpha * R}{G * e} = \frac{10kN * 12m * 11,5m + 81,36 * 0,36 * 11,4}{22,6 * 2 * \sin 60^\circ * 3,5} = \frac{1368 + 334}{39000kg * 3,5 * 10N} = \frac{1702kN m^3}{1365kN m^3} = 1,25_{her}$$

$K_s = 1,25_{her}$

$N = V * \gamma * f * \cos 60^\circ = 22,6 * 2 * 0,36 * 0,5 * 1000 = 8136kg$ ose 81360N ose 81,36kN

G – Masa e ngarkuar për rrëshqitje = $V * \gamma * \sin \alpha = 22,6 * 2 * \sin 60^\circ = 39 * 1000 = 39000kg$
e - Rrezja e masës = 3,5m

C- Kohezioni minimal = 0.1dN/cm²1dN=1kg

F- Sipërfaqja rrëshqitëse 12m²

R- Rezja e harkut rrëshqitës. 11.5m si në figurë

$\sum N$ - Forcat e fërkimit të masivit që e pengojnë rrëshqitjen kN

δ - Këndi i fërkimit të brendshëm për argjila të ngjeshura. 20⁰ ose $\text{tng} 20^\circ = 0,36$

Parametrat i kemi nxjerr nga analizat e vetive fiziko mekanik të dherave.

Për $K_s = 1,25_{here}$ ka ndikuar kryesisht koeficienti i lidhshmërisë $C=0,1dN/cm^2$

Këtu e kemi llogarit K_s për shpatin punues (për pjesën e shrafiuar)

Në praktik shihet se shkëmbit gëlqeror kanë siguri të lart në shembje, përveç kur ka qarje dhe presion hidro statik gjatë reshjeve të mëdha (dimrit apo në pranverë).




TABELA E KËNDEVE α° dhe β°

Lloji i materialit	β°	α°
Shkëmbinj monolit	Deri 90	75-85
Shkëmbinj vullkanik	70-80	70-75
Shkëmbinj sendimen.	60-70	60-65

Lartësia e shkallës h është përcaktuar sipas përvojës së fituar për karrierat në shkëmbinj gëlqeror.

Në lartësinë e shkallës ndikojnë:

-Pjerrtësia e terrenit

-Prodhimtaria


-Mekanizmi me të cilin disponon investitori

-Siguria në punë, vendbanimi etj.

Këndi i pjerrtësisë së ballit punues $\beta = 70^\circ$ merret nga tabela për shkëmbinj sedimentar.

-Rënia ose këndi gjeneral i pjerrtësisë së karrierës γ_k caktohet sipas të dhënave:

Profil i fazës përfundimtare të shfrytëzimit



$$\operatorname{tg} \gamma_k = H / \sum b + \sum h \times \operatorname{ctg} \alpha$$

$$\sum b = (\eta - 1) \times b$$

α -pjerrtësia e shkallës për fazën përfundimtare. Përvetësohet nga tabela për shkëmbinj sedimentar

$\alpha = 60^\circ$ h-lartësia e shkallës; $h = 10_m$ b-gjerësia e bermës përfundimtare; $b = 5m$ n -numri i shkallëve; $n = 7$

$\gamma_k - \gamma_2$ këndi gjeneral i stabilitetit të karrierës është përvetësuar nga literature për mihjet sipërfaqësore $\gamma_k = 50^\circ$

$$\operatorname{tg} \gamma_k = 70 / \sum 30 + \sum 70 * \operatorname{ctg} \alpha = 70 / 30 + 70_m \times \operatorname{ctg} 60^\circ = 70 / 30 + 70 * 0.577 = 70 / 30 + 40.39 = 70 / 70.4 = 0.994$$

$\operatorname{tg} \gamma_k = \operatorname{arc} \operatorname{tg} 0.994 = 44.8^\circ$ Përputhet me profilin e fazës përfundimtare të shfrytëzimit. $\gamma_k \approx 44.8^\circ$ – përputhet me literaturë për mihjet sipërfaqësore.

Konsumi specifik i lëndës eksplozive

Një prej formave analitike, e cila shfrytëzohet për përcaktimin e llojit të eksplozivit, njihet si metoda e Impedanca akustike.

Sipas këtij kushti, në të cilin bazohet kjo metodë, është kur energjia max. e shfrytëzuar e eksplozivit arrin kur impedanca akustike e eksplozivit dhe impedanca e shkëmbit, I cili minohet janë të barabarta.

$$\rho_o \times D = k \times \gamma_{sh} \times C_{lm}$$

$\rho_o \gamma_{sh}$ - masat vëllimore e eksploatimit të shkëmbit

D-shpejtësia e detonacionit të eksplozivit

C_{lm} -shpejtësia e valëve elastike gjatësore në mesin ku kryhet minimi.

$K = 0.65 - 0.80$ faktori i korreksionit.

$$C_{lm} = \sqrt{9E / \gamma} \dots \dots m/s$$

g – nxitimi i gravitacionit m/s^2

E - moduli i elasticitetit

Për përcaktimin e konsumit specifik të lëndës eksplozive në literaturë ekzistojnë një numër i madh i formulave empirike.

Prej tyre si më e përshtatshme merret formula:

$$Q=0.27 \cdot \sqrt[3]{f} \dots \text{kg/m}^3$$

f - koeficienti i protagjakonovit $\tau / 100$

$$f = 3-5$$

$$q=0.27 \times \sqrt[3]{5} = 0.46 \text{kg/m}^3$$

Përcaktimi i vijës më të vogël rezistuese

$$W=35d_b=35 \cdot 0.086=3.01 \text{m}$$

Përvetëojmë: $W=3 \text{m}$

4.6. Distanca mes vrimave dhe rendeve

Distanca mes vrimave

$$a_v = m \cdot w = 1 \times 3 = 3 \text{m} \quad a \approx w$$

a_v – distanca në mes të vrimave

m - koeficienti i afërsisë i cili sillet prej 0.75-1.2

Nga kjo shihet se: $w > a_v$ ose $3.01 > 3$

Distanca në mes rendeve

$$b_r = kw$$

b_r -distanca në mes rendeve

k -koeficient 0.6-1.10 $k=0,9$

$$b_r = 0,9 \cdot 3 = 2.7 \text{m}$$

Gjatësia e shpimit

Për rastin e karrierës në vend burimin e gëlqerorëve në Klev, këndi i pjerrtësisë së shpimit të vrimave do të jetë: $\beta = 70^\circ$

Atëherë gjatësia e shpimit do të jetë:

$$L_{sh} = h + l_{tej} / \sin \beta = 10 + 0,5 / \sin 70^\circ = 10,5 / 0,94 = 11,17 \text{m} \quad L_{sh} = 11 \text{m}$$

h - lartësia e shkallës..... $h=10 \text{m}$.

l_{tej} - thellësia e tej shpimit.... $0,5 \text{m}$.

β - këndi i pjerrtësisë së vrimës..... 70°

Sasia e masës së minuar për një vrimë

$$V_m = a \cdot m \cdot w \cdot h = 3 \cdot 1 \cdot 2.7 \cdot 10 = 81 \text{m}^3.$$

Masë kompakte që i plotëson shpenzimet e harxhimit specifik të lëndës eksplozive.

Intervali mili sekundar

Intervali mili sekundar është:

$$T = 2 \cdot W \cdot \sqrt{\frac{\gamma}{q}}$$

Ku janë: w -vija më e vogël rezistuese

γ -masa vëllimore e gëlqerorit..... 2.7t/m^3

q -konsumi specifik i lëndës eksplozive... 0.46kg/m^3

$$\text{atëherë } \tau = 2 * 3 \sqrt{\frac{\gamma}{q}} = 2 * 3 \sqrt{\frac{2.7}{0.46}} = 6 * 2.4 = 14.5 \text{ mili sec.}$$

Që do të thotë se mund të përdorën të gjithë mili sekundarët ngadalësues deri në 40 mili sec. E që më së shpeshti përdorën ngadalësuesit prej 25 mili sec. Duhet të ketë kujdes që gjatë minimumit të mos bëhet ngadalësim i madh, mbi 40 mili sekonda për shkak se mund të vij deri te këputja e fitilit detonus. Gjatë minimumit mund të dështojnë edhe ngadalësuesit, e posaçërisht kur qëndrojnë një kohë të gjatë në ajër me lagështi. Tani kanë filluar minimet me nonellë. Këto minime mund ti bëjnë personat e autorizuar me përvojë. Gjatë minimumit me nonell duhet me pas kujdes në vonesa të betonimit gjatë minimumit. Në rregulloren e mbrojtjes thotë :Koha e betonimit në vrimë zgjat 2 mil.sek kurse për 5 mil.sek përfundon procesi i detonimit. Prandaj çdo vonesë mbi 2 - 5 mil.sek rrezikon shkatërrimin e mësipërm të detonimit. Gjithë ashtu duhet të llogaritet edhe koha e ndezjes në fitilin e nonellit e cila është 2,1m për një mil.sek. Në skemën grafike janë paraqit dy mënyrat e minimumit: me fitil detonus dhe nonell.

▪ **Llogaritja e veprimit të lëndës plasëse**

Gjuajtja maksimale gjatë minimumit të shkëmbit varet nga:

d_b - diametri i mbushjes me lëndë eksplozive....70mm

l_t -taposja e vrimës..... $w=3m$

Për gjatësinë e taposjes l_t , e cila është e barabartë me 40 diametra të mbushjes me lëndë plasëse, a më e vogël se $l_t = w$

Lartësia e gjuajtjes do të jetë:

$$L_o = 40^3 \sqrt{d_b^2} = 40^3 \sqrt{7^2} = 146m \quad L_o = 146m$$

Largsija e hudhjes së gurve nga ekësplozivi gjatë minimumit

$$L = x = V_0 * t * \cos\alpha = V_0 * 2V_0 \sin\alpha / g * \cos\alpha = V_0^2 / g * 2\sin\alpha \cdot \cos\alpha$$

$$t = 2V_0 \sin\alpha / g$$

$$L = V_0^2 / g * 2\sin\alpha \cdot \cos\alpha = V_0^2 / g * \sin 2\alpha.$$

Llogaritja për këndin $\alpha = 45^0$ që merret si gjujtje më e largët


$$\sin 45^0 = \cos 45^0 = \frac{\sqrt{2}}{2}$$

$$L = V_0^2 / g * 2 * \frac{\sqrt{2}}{2} * \frac{\sqrt{2}}{2} = V_0^2 / g * 2 * 2 / 4 = V_0^2 / g * 4 / 4 = V_0^2 / g$$

L_{max} është kur hudhja e gurve bëhet përej vrimë në kënd $\alpha = 45^0$

$$L_{max} = V_0^2 / g * \sin 2 * 45^0 = V_0^2 / g * \sin 90^0 = V_0^2 / g * 1 \text{ ose}$$

$$L_{max} = \frac{V_0^2}{g} \quad X = V_0^2 / g \quad Y = gt^2 / 2$$



Konstruktimi dhe mbushja e vrimave.

Pas shpimeve çdo vrimë e shpuar mbyllet me dru special për tu mbrojtur nga mbushjet me materiale.

Në mihje sipërfaqësore po i mbyllin me kесе të mbushur me rërë dhe lëshohet mbi verim . edhe kjo mënyrë e mbylljes është e lehtë dhe praktike.

Para mbushjes vrima kontrollon me shufër të drurit me trashësi të diametrit të llokumit dhe lidhet me litar, në këtë mënyrë bëhet pastrimi dhe kontrollimi i vrimës.

Në qoftë se vrima është e mbushur ajo pastrohet ose shpohet vrima e re.

Lënda eksplozive vendoset në vrimë njëkohësisht me fitilin betonues në tërë gjatësinë e vrimave me që rast llokumin e parë e lidhet me fitil detonus.

Sipas rregullave të xehetarisë për shpime me kënd mbi 70° Llokumin e eksplozivit nuk lejohet të lëshohet me rënie të lirë por ajo lidhet e lëshohet me fitil detonus apo litar tjetër. Taposja e vrimës mes eksplozivit bëhet me rërë të shkëmbit të shpuar e cila duhet të jetë e terur.

Gjatë taposjes së vrimës fitili duhet të largohet dhe të mbështetet në një skaj të vrimës dhe nuk guxon të tërhiqet fort. Gjatësia e taposjes nuk preferohet të jetë më e vogël se vija rezistuese (w).

Mbushja teorike e shpim plasjes

Amonit i përforcuar $\Phi = 70_{mm}$

$A_{te} = (d_p^2 * \pi * \rho_a * l) / 4$ Ku janë:

d_p - diametri i llokumit të lëndës eksplozive 70mm l'-gjatësia e vrimës ..11m.

ρ_a - dendësia e L.E.....1.1kg/dm³

5.3. Mbushja praktike e vrimave

Mbushja praktike dhe ajo teorike dallohen në mes veti për arsye të mbushjes së lirë të vrimës me lëndë eksplozive.

Diametri i vrimës është $d_v = 86_{mm}$, ndërsa diametri i mbushjes, gjegjësisht llokumit do të jetë $d_p = 70_{mm}$, d.m.th. për 16mm më i vogël d_p se d_v .

Mbushja e vërtetë e mbushjes përcaktohet sipas formulës:

$$\frac{m * d^2 * \pi}{4} \frac{100}{1000} = \frac{1.1 * 7^2 * 3.14}{4} \frac{100cm}{1000gr} = 4kg / m$$

Normativi i materialit për shpim-minim në gurthyes

Konsumi specifik	0,38 kg _e /m ³
Fitili detonus	0.30m/m ³
Dinollajt	300m/për minim
Detonator - nonell	0.08copë/m ³
Ngadalësues	0.01copë/m ³
Energjia elektrike	2.07kwh/m ³
Vaji	0.013 l/m ³
Gypa shpues	0.00016 copë/m ³
Kurora shpuese	0.00026 copë/m ³

▪ **Konsumi specifik i eksplozivit:**

$$q=30,8/81 =0,38 \text{ kg}_e/\text{m}^3$$

Vrima L=11_m mbushet me eksploziv 70% ose 7_m kurse 4_m jetë për tamposje, 1m bëhen tamposje në mes mbushjes me eksploziv kurse 3_m mbesin për tamposje në krye të vrimës e tërë kjo shihet në skemën e mbushjes së vrimës.

Për 1_m tamposje janë të nevojshëm 6 dm³ rërë.

Nëse vrima është e shpuar me diametër të kurorës 76 mm,

Mbushja bëhet me llokum me trashësi 60_{mm} në këtë rast nuk ka taposje në mes të llokumav.

Është shumë me rëndësi afati i eksplozivit i cili është 6 muaj. Nëse eksplozivi është me afat të kaluar fillon ti bie kualiteti që gjatë minimumit vërehet dukshëm. Minimi me eksploziv me afat të pa kaluar është më efikas.

Veprimi seizmike në objekte sipërfaqësore

Sasia e lejuar e eksplozivit e cila do të aktivizohet në të njëjtën kohë (me saktësi të mjaftueshme) përcaktohet sipas barazimit

$$Q_{lej}=V_{lej}^2 \cdot L^4 / 1000v \dots \dots \text{kg}$$

Q_{lej} - sasia e lejuar e lëndës eksplozive....kg

V_{lej}- shpejtësia e lejuar e oscilimeve të trupit 0.4-0.8cm/s për shkallën e tretë të Merkalit.

L- distanca prej vendit të eksplodimit deri te objekti më i afërt.

V- shpejtësia longitudinale, për kushtet e këtij gurëthyysi merret

$$V=4 \text{ km/s.}$$

$$Q_{lej}=0.0036 \cdot 200^4 / 4000 < 1440 \text{kg/vrimë}$$

Ndërsa te ne sasia maksimale e eksplozivit për një vrimë është 37,8_{kg} eksploziv që i plotëson të gjitha kushtet.

Veprimi i valës goditëse ajrore

Në vendin e eksplodimit, në rrethinën e këtij vendi, vala goditëse ajrore arrin disa qindra -mijëra Njuton.

Prandaj duhet të llogaritet veprimi i valës goditëse në njerëz dhe në objekte.

Rrezja e rrezikshme e valës goditëse ajrore në njerëz llogaritet sipas relacionit

$$R=5 \sqrt{Q_{max}}$$

R-rrezja e zonës

Q_{max}- sasia maksimale e L.E llogaritet të jetë

$$Q_{max}=5000 \text{kg}$$

Atëherë

$$R=5 \sqrt{5000}=5*70.7=353\text{m}$$

Rrezja e veprimit të rrezikshmërisë të valës goditëse ajrore në objektet për rreth

Ilogaritjet sipas relacionit: $R_{ob}=K_v \sqrt{Q_{max}}$

K_v – koeficienti i proporcionit, madhësia e të cilit varet nga Q_{max} .

Për sasinë $Q_{max}=5000\text{kg}$ përvetësohet $K_v=1.5$ atëherë:

$$R_{ob}=K_v \sqrt{Q_{max}}=1.5 \sqrt{5000}=106\text{m}$$

$$R_{ob}=106\text{m}$$

Sipas rregullores së mbrojtjes goditja ajrore për minime të shpeshta në mihjet sipërfaqësore, lejohet 1 milibar

Për minime të rralla 3÷2 minime në vit, lejohet ngritja deri 4÷5 mili bar

Nëse dyshohet se gjatë minimumit goditja ajrore do të arrij mbi 3 milibar duhet që para dhe pas minimumit të përcillet gjendja e objekteve për rreth.

Për minime të mëdha duhet të përcillet dhe të bëhen matjet e goditjes ajrore në objekte për rreth.

Në këto raste duhet të kontrollohet objektet a kanë ndonjë të qar para minimumit dhe pas minimumit.

Që të mos dalin dyshime se gjatë minimumit, nga dridhjet kanë ndodh dëme në objekte.

▪ KAPACITETI I KARRIERËS DHE PERIUDHA E EKSPLOATIMIT

Rezervat gjeologjike në ngastër për shfrytëzim janë: **V_{gj}=2271276m³**

Në vend burim ka ~7% argjilë.

Rezervat gjeologjike të shkëmbit gëlqeror për shfrytëzim janë: $V_{gj}=2271276-2271276*0.07=2112287\text{m}^3$

Rezervat e shkëmbit gëlqeror janë: **V_{gj}= 2112287m³**

Një pjesë e rezervave mbesin në bermë dhe skarpat në fazën përfundimtare të shfrytëzimit.

Rezervat e shkëmbit për shfrytëzim janë:

E kemi bërë llogaritjen e rezervave të shfrytëzueshme me autokad në mes dy sipërfaqeve: të pikave detale dhe të pikave të shfrytëzimit në fazën përfundimtare.

$V_{sh} = 1244988\text{m}^3$ rezervat e shfrytëzueshme janë: $1244988\text{m}^3-7\%$ djerrin= $1244988-87149.16=1157838.84\text{m}^3$

V_{sh}=1.157839m³

Kompania është duke e përgatit dokumentacionin për leje të shfrytëzimit në mihjen sipërfaqësore..

Duke u bazuar në aftësitë e kompanisë për prodhim, e cila është në fazën e përgatitjes për punë në mihjen sipërfaqësore, prodhimtaria orare

Q_h do të jetë: Q_h =60m³/h

Prodhimtaria në një turn është :

$$Q_t = t_e \times Q_h = 7 \times 60 = 420\text{m}^3 / \text{ndërrimë}$$

$$t_e - \text{Koha efektive gjatë një ndërrimi } t_e = 7 \text{ h}$$

Në mihjen sipërfaqësore do të punohet në një turn .

Prodhimtaria ditore është :

$$Q_d = Q_{tu} = 420\text{m}^3 / \text{dit}$$

Prodhimtaria mujore është:

$$Q_m = Q_d \times n_{dm} = 420 \times 20 = 8400 \text{ m}^3 / \text{muaj}.$$

Prodhimtaria vjetore llogaritet të jetë:

$$Q_{vj} = Q_m \times n_{mu} = 8400 \times 10 = 84000 \text{ m}^3 / \text{vjet}$$

Numri i ditëve të punës në muaj: $n_{dm} = 20$ ditë pune

Numri i muajve në vit.....: $n_{mv} = 10$ muaj

Sipas kësaj dinamike jeta e karrierës do të jetë

$$T = V_{sh} / V_{vj} = 1157839 / 84000 = 13.8 \text{ vjet ose}$$

T=13.8 vjet Nga kjo shihet se ka rezerva të mjaftueshme që kompania ta rris prodhimtarin vjetore

Impianti

Kompania është duke e pregadit impiantin për ndarjen e fraksioneve të ndryshme. Duke u bazuar në rezerva të mëdha të shkëmbit gëlqeror, kompania duhet të paiset me impiant me kapacitet të lart që bën prodhimin e të gjitha fraksioneve për kërkesat e tregut, me thërrmojës primare dhe sekondare. Kapaciteti i thërrmojës primare dhe sekondare duhet ti plotësojë kushtet e prodhimtarisë vjetore. Në mënyrë që thërrmojësia të punoi pa pengesa, është e nevojshme që dimensionet e shkëmbinjve të jenë së paku 20% më të vogël se dimensionin pranues i thërrmojës primare.

Thërrmimi sekondar

Sado që minimi të bëhet në mënyrë profesionale dhe në harmoni me rregullat teknike-minerare të minimit, prapë lajmërohen shkëmbinj me dimensione të mëdha të cilët duhet të thërrmohen me çekan hidraulik.

Gjatë procesit të minimit zakonisht ky dështim të shumtën e rasteve lajmërohet në masën

15-20%.

MASAT MBROJTËSE

Gjatë kryerjes së punëve në mihjen sipërfaqësore, kryesi i punës duhet tu përmbahet rregullave tekniko-minerare të shfrytëzimit sipërfaqësorë.

Të gjitha pjerrtësitë e shkallës (skarpat) në karrierë duhet të ndërtohen sipas këndit të dhënë në projekt.

Afër kufijve të karrierës duhet të vendoset shenja e ndalimit të personave të pa autorizuar.

Të shënohen kufijtë e karrierës dhe të thuret karriera, në mënyrë që të evitohet rënia e gjallesave në karrierë.

Në hyrje të rrugës kryesore të karrierës duhet të vendosen shenjat e mihjes sipërfaqësore.

Para fillimit të punëve në shkallë, a zakonisht pas një periudhe të gjatë ndërprerje, duhet të verifikohet pjerrtësia e shkallëve, mundësit e paraqitjes së shkarjeve dhe pjesëve të cilat rrezikojnë duhet të largohen.

Te gjitha gropat me thellësi mbi 1m duhet të mbyllen ose të thurën.

Ndalohet përdorimi i alkoolit dhe barnave që e zvogëlojnë aftësinë e punës në karrierë, si dhe personat të cilët janë nën ndikimin e alkoolit të largohen nga karriera.

Ndalohet hyrja e punëtorëve nën lugën e ekskavatorit.
 Nuk lejohet kalimi I lugës së ngarkuesit mbi kabinën e kamionit.
 Punëtorët në karrierë duhet të pajisën me veshmbathje për mbrojtje në punë: të kenë helmata, dorëzat, rrobat për punë, mbathje për punë, antifona në veshë(kundër zhurmës). Filtra të vendosur në gojë për mbrojtje nga pluhuri
 Kompania e mihjes sipërfaqësore gjatë kohës së thatë duhet ti mirëmbaj rrugët duke i stërpik për neutralizimin e pluhurit.

Udhëheqësi teknik i karrierës shpesh here duhet të lëshoj urdhëresa me shkrim për punë dhe mbrojtje në karrierë.

Masat e posaçme mbrojtëse

Gjatë kryerjes së punëve në karrierë dhe punës në periudhën e eksploatimit të shkëmbinjve gëlqeror, kryesi i punëve duhet tu përmbahet rregullave teknike-minerare të shfrytëzimit sipërfaqësor.

13. Të gjitha pjerrtësitë e shkallës së karrierës duhet të ndërtohen sipas këndit të dhënë në projekt.

Afër kufijve të karrierës duhet të vendoset shenja e ndalimit të personave të pa autorizuar.

Në hyrje të rrugës kryesore të karrierës duhet të vendoset shenja e gurthyesit.

Para fillimit të punëve në shkallë, a zakonisht pas një periudhe të gjatë ndërprerje, duhet të verifikohen pjerrtësitë e shkallëve, mundësitë e paraqitjes së shkarjeve dhe pjesët të cilat rrezikojnë punën duhet të mënjahen , në atë mënyrë që punëtori të lidhet me litar për brezi (special për lidhje) e kur sesi të afrohet pa u lidhë.

Para çdo minimi rreth karrierës duhet të bëhet sigurimi dhe të tregohet rreziku nga minimi .

Mbi këqyrjen e të gjitha punëve në karrierë gjatë minimumit e bën inxh. i xehetarisë.

Minimumin me lëndë eksplozive e bënë ekskluzivisht xehetari me provim të dhënë për ndezës të minave dhe verifikim të dijes çdo gjashtë muaj.

Punët tjera përcjellëse i bënë edhe ndihmës xehetari por në mbi këqyrjen të plotë të xehetarit.

Punëtorët të cilët operojnë me lëndë eksplozive e kanë të ndaluar përdorimin e duhanit dhe alkoolit në kufijtë e karrierës.

Masa e sigurisë para minimumit epen nga aspekti i përcaktimit të zonës së pa rrezikshme nga fluturimi i copave të shkëmbit dhe valës goditëse ajrore.

Parametrat e fluturimit të copave përcaktohen sipas ligjit të hedhjes së pjerrët, ku rezistenca e ajrit nuk merret para sysh.

